



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROPOZIM

STATUTI

I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE NË LIPJAN

Lipjan, 2025

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) nenit 48 pika 6, dhe nenit 52 pikës 6 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 08/L-255 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 1/5 Janar 2024) si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110 -78095, të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e mbajtur më, _____ 2025, miraton:

PROPOZIM

STATUTIN E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE NË LIPJAN

Kapitulli I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimi

1. Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Lipjan, është akti i përgjithshëm themelor i Institucionit publik, të cilin e miraton Kuvendi i Komunës. / Në tekstin e mëtejme Statuti/.
2. Sipas këtij Statuti, Qendra për Punë Sociale është institucion administrativ dhe profesional Komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale./ në tekstin e mëtejme QPS/ .

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij Statuti është krijimi i një kornize rregullative për organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Qendrës për Punë Sociale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 Objekti i Rregullimit

Me këtë Statut rregullohet: nocioni, emërtimi, selia, simbolet, statusi juridik prezantimi dhe përfaqësimi, kompetencat dhe përgjegjësitë, veprimtaria dhe shërbimet, pronësia, buxheti dhe financat, transparencia, konfidencialiteti, etika dhe kompetenca në përcaktimin e taksave për shërbime administrative në kuadër të QPS-së .

Neni 4 Qendra për Punë Sociale

1. Sipas këtij Statuti, Qendra për Punë Sociale - QPS është institucion publik administrativ dhe profesional komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, brenda territorit administrativ të Komunës.
2. QPS kujdeset që banorët e saj në nevojë të realizojnë të drejtat për shërbimet sociale dhe familjare, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, dhe orientime tjera, sipas kompetencës profesionale dhe administrative në Komunën e Lipjanit.

Kapitulli II EMËRTIMI, SELIA DHE SIMBOLET

Neni 5 Emërtimi, selia dhe simbolet e Qendrës për Punë Sociale

1. Emri i Institucionit është: QENDRA PËR PUNË SOCIALE – LIPJAN.
2. Selia është Objekti i Qendrës për Punë Sociale: LIPJAN.
3. Emërtimi: Qendra për Punë Sociale, vendoset në Objekt, shkruar në gjuhë zyrtare.
4. Për ndryshimin e emrit dhe të selisë së Qendra për Punë Sociale, vendos Kuvendi i Komunës.
5. Qendra për Punë Sociale në komunikim zyrtar, bartë stemën e Komunës së Lipjanit dhe të Republikës së Kosovës dhe ka vulat e saj në qarkullim të cilat kanë formën dhe dimensionet konform standardeve të përcaktuara me dispozita ligjore.

Kapitulli III

STATUSI JURIDIK, PREZANTIMI DHE PËRFAQËSIMI

Neni 6

Statusi dhe përfaqësimi juridik i Qendrës për Punë Sociale

1. Qendra për Punë Sociale është Institucion me status të subjektit/ juridik – publik, me kompetencë profesionale dhe administrative për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve sociale dhe familjare si dhe aktiviteteve tjera në përmbushjen e detyrimeve ligjore, brenda kornizës administrative dhe territoriale të Komunës.
2. Qendra për Punë Sociale, mund të ketë një apo më shumë njësi organizative brenda kompetencës territoriale, siç parashihet me ligj.
3. Në cilësinë e subjektit publik, QPS në kornizën e saj administrative mund të krijoj njësi të veçantë për këshillim familjar, me akt-themelim nga Komuna.
4. Asnjë organ tjetër përveç QPS-së nëse nuk është e përcaktuar shprehimisht me ligj nuk ka mandat të ndërhyjë apo të ndikojë në ndonjë mënyrë tjetër lidhur me menaxhimin profesional, të cilit do rast të shërbimeve sociale dhe familjare apo të ketë qasje në të dhënat konfidenciale.
5. Qendra për Punë Sociale në Lipjan funksionon në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe menaxhohet nga Drejtori/a i/e institucionit i cili kryen detyrat ,përgjegjësitë dhe përfaqëson QPS-në konform kompetencave të përcaktuara me dispozitat e legjislacionit në fuqi .
6. Aktet juridike në të cilat bazohet QPS gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësiave janë: ligjet, statuti, aktet nënligjore të nivelit qendror si dhe rregulloret dhe vendimet e ndryshme që miratohen në nivel të Komunës përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e Institucionit (QPS).

Neni 7

Kompetencat e Qendrës për Punë Sociale

1. Qendra për Punë Sociale :

- a) vendos në shkallë të parë për autorizimet themelore dhe të zgjeruara nga shërbimet sociale;
- b) zbaton vendimet gjyqësore;
- c) organizon dhe ofron drejtpërdrejt shërbimet sociale;
- d) vlerëson nevojat e përfituesve dhe planifikon ofrimin e shërbimeve.
- e) inicion dhe organizon aktivitete parandaluese për fushën e shërbimeve sociale;
- f) identifikon në fazë të hershme, përcjell dhe analizon problemet e përfituesve nga fusha e shërbimeve sociale;
- g) zbaton aktivitete në fushën e parandalimit të trafikimit me njerëz, të dhunës në familje, të dhunës së bashkëmoshatarëve dhe të problemit të varësisë;
- h) lëshon dëshmi, vërtetim, konstatim mbi bazën e vlerësimit të gjendjes faktike të personit apo familjes;
- i) jep mendime dhe vlerësime profesionale, ofron të dhëna për rrethanat familjare, propozime dhe rekomandime në procedura gjyqësore lidhur me mbrojtjen familjare juridike;
- j) zbaton metodat e punës sociale, menaxhimin e rastit, metodat e tjera profesionale dhe shfrytëzon shërbimet e këshillimoreve dhe institucioneve tjera profesionale për ofrimin e shërbimeve sociale për përfituesit;
- k) merr pjesë si palë përfaqësuese në gjykatë dhe organe tjera shtetërore kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve të cilët nuk mund të kujdesen vetë për vetën për të drejtat dhe interesat e tyre;
- l) kryen mbikëqyrjen ndaj familjeve strehuese dhe për përfituesit e shërbimeve në strehim familjar dhe në strehim rezidencial.
- m) mban evidencën dhe dokumentacionin për të drejtat, për shërbimet e ofruara dhe masat e ndërmarra në kuadër të veprimtarisë së vet;
- n) Qendra për Punë Sociale në bazë të autorizimeve publike mund të ofrojë masa të mbrojtjes përmes formave alternative të përkujdesjes për fëmijën e ikur apo

languar nga prindërit apo institucioni, ofron dhe zbaton masat edukuese ndaj fëmijës me ç'rregullime në sjellje jashtë familjes së tij apo me qëndrim në familje.

- o) kryen edhe punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 8

Përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale

1. Përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale janë si vijon;

- a) Ushtrimi i veprimtarive nga kompetenca që i'a jep Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.
- b) Ushtrimi i kompetencës nga Organi i Kujdestarisë.
- c) Promovimi dhe zhvillimi i strehimit familjar, për fëmijët pa kujdes prindëror.
- d) Kryesimi i tryezës për menaxhimin e rasteve; fëmijë, me rrezik të mesëm dhe lartë, siç është përcaktuar me akt-nënligjor.
- e) Caktimi i zyrtarit përkatës, përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës,
- f) Vlerësimi profesional për secilin individ apo familje që jeton ose gjendet në territorin e Komunës së Lipjanit e që kërkon ndihmë ose në ndonjë mënyrë mësohet apo shihet se ka nevojë për shërbime sociale apo të mbështetjes materiale.
- g) Përcaktimi i nevojës për realizimin e të drejtave në shfrytëzimin e shërbimeve sociale në bazë të vizitës vlerësuese të drejtpërdrejtë të kryer në shtëpinë apo banesën e përfituesit.
- h) Ofrimi i shërbimeve sociale, të mbrojtjes alternative dhe mbështetjes materiale, sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria.
- i) Administrim dhe përfshirje sociale të familjeve në Skemën e Asistencës Sociale, siç është përcaktuar me ligj.
- j) Ngritja e kapaciteteve profesionale përmes aftësimit të vazhdueshëm në pajtim me ligjin.

- k) Planifikimi dhe raportimi vjetor për shërbime sociale.
- l) Zbatimi i rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacion për ushtrimin e kompetencës profesionale dhe administrative.
- m) Zbatimi i kompetencave tjera të përcaktuara me ligjet në fuqi.

Kapitulli V

VEPRIMTARIA E QENDRËS PËR PUNË SOCIAE DHE PËRFITUESIT E SHËRBIMEVE SOCIALE

Neni 9

Veprimtaria dhe përfituesit e shërbimeve sociale

1. QPS ushtron veprimtari në ofrimin e shërbimeve sociale dhe të mbështetjes materiale për banorët në nevojë të Komunës si një dimension me interes të veçantë për mirëqenien e qytetarëve, në kuadër të kompetencës që i jep Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe ligjet tjera përkatëse në fuqi.
2. Sipas Statutit, shërbimet sociale dhe familjare në kuadër të veprimtarisë së QPS-së nënkuptojnë përfshirje në; aktivitete, shërbime, masa, forma të mbrojtjes të destinuara për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e jetës së individit dhe familjes në nevojë për mbështetje sociale në Komunën e Lipjanit.
3. Përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare nga veprimtaria e QPS-së janë individit, anëtarit i familjes dhe familjet, të cilët realizojnë të drejta dhe shërbime si në vijim:
 - Mbështetje apo ndihmë individuale, familjare, dhe në komunitet, pavarësisht moshës, aftësisë së kufizuar, dhe problemeve sociale.
 - Mbështetje /fuqizim individual e familjar në tejkalimin e përjashtimit shoqëror.
 - Fuqizim/parandalim të ndarjes në ruajtje të unitetit familjar, dhe interesit më të mirë të fëmijës.
4. Format alternative të mbrojtjes për përfituesit e shërbimeve sociale, përcaktohen nga Organi i Kujdestarisë, si në vijim:

- a) kujdestari;
- b) strehimit familjar;
- c) strehimit rezidencial;
- d) Adoptimit; dhe,
- e) Formave tjera të përkujdesjes.

5. QPS ofron shërbime sociale të integruara, gjithëpërfshirëse, emergjente, të siguruara nga Komuna/Ministria. Shërbimet e integruara rregullohen me akt nënligjor nga Ministria përkatëse.

6. Qendra për Punë Sociale vepron në bazë të kompetencave që i jep Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, standardeve të specifikuara nga Ministria , përfshirë strukturën dhe llojin e profesionistëve nga shkenca e punës sociale, pedagogjisë, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë ose në ndonjë lëmie tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare.

7. Në këtë statut, përfshihet edhe Shërbimi i Asistencës Sociale, kompetent në ofrimin e ndihmës sociale për familjet në nevojë.

8. Qendra për Punë Sociale kryen edhe shërbime administrative dhe financiare sipas kompetencës për lëndët nga fushëveprimtaria e saj.

9. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, mund t'u japë udhëzime për masat që duhet të ndërmarren për harmonizimin e cilësisë së shërbimeve me standarde ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në QPS.

10. Komuna zbaton standardet minimale dhe aktet tjera normative për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare të përcaktuara nga Ministria kompetente për çështje sociale.

Kapitulli VI

ORGANI I KUJDESTARISË

Neni 10

Organi i Kujdestarisë dhe Përgjegjësitë.

1. Organi i Kujdestarisë vepron në kuadër të QPS-së i cili është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë.
2. Përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e Organit të Kujdestarisë është Sektori i Shërbimeve Sociale në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.
3. Organi i kujdestarisë përcakton kategoritë përkatëse për fëmijën dhe të rriturit që do të përfitojnë nga format mbështetëse të mbrojtjes sipas kompetencës ligjore.

Kapitulli VII

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Neni 11

Struktura dhe funksionimi i Qendrës për Punë Sociale

1. Qendra për Punë Sociale funksionon në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Lipjan.
2. Struktura, udhëheqja dhe organizimi i brendshëm i QPS-së është rregulluar me organogramin e komunës në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe mund të ndryshohet dhe plotësohet varësisht nga ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 12

Shërbimet Sociale

1. Qendra për Punë Sociale në kuadër të kompetencave të përcaktuara ligjore stafit profesional bën ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, përmes metodave të punës

sociale dhe metodave tjera, me qëllim të rritjes së mirëqenies së individit, familjeve të cenuara në komunitet.

2. Shërbimet sociale kanë rolin veprues në eliminimin e rreziqeve, zbutjen e varfërisë, përmirësimin e përfshirjes dhe integritimit me qëllim të arritjes së potencialit të plotë në jetë, për individët/përsonat dhe familjet në nevojë.

2.1. Person në nevojë, nënkupton person/at që gjendet në territorin e komunës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të është;

- a) fëmijë pa përkujdesje prindërore; në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror ,me vështirësi në sjellje;
- b) viktimë e abuzimit dhe keqtrajtimit, përfshirë atë fizik, psikologjik; seksual dhe lënien pas dore, përfshirja e fëmijëve në punë të rënda;
- c) fëmijë në konflikt apo në kontakt me ligjin;
- d) të marrëdhënieve të çrregulluara në familje;
- e) të moshës së shtyrë, të aftësisë së kufizuar fizike, mendore.
- f) të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi;
- g) të dhunës në familje dhe çfarëdo lloji tjetër dhune në bazë gjinore;
- h) të trafikimit me qenie njerëzore;
- i) të varësisë nga substancat psiko-aktive, siç janë: alkooli, drogat apo ndonjë lëndë tjetër natyrale apo farmaceutike që shkakton varësinë;
- j) të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu;
- k) të ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona në nevojë.

2.1.1. Familje në nevojë; familja kur njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit i nevojitet ndihma, apo rastet kur kërkohet përkujdesja për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës.

3. Shërbimet sociale, klasifikohen në shërbime:

- Parësore (parandaluese)
- Dytësore (specializuara)
- Tretësore (kujdesit të vazhdueshëm dhe intensive/24 orë)

Secila shkallë e klasifikimit/grupimit të shërbimeve sociale (parësore, dytësore, tretësore) është e ndërlidhur në menaxhim të rasteve/ klientëve të Qendrës për Punë Sociale, sipas paragrafit 2.1 dhe nënparagrafit 2.1.1 të këtij neni.

4. Komuna dhe Ministria përkatëse, bartë përgjegjësinë e sigurimit të shërbimeve sociale, sipas paragrafit 3 të këtij neni për t'iu përgjigjur nevojave të përfituesit/ve, Qendra për Punë Sociale për ofrimin e shërbimeve sociale.

5. Ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare janë profesionistët me kualifikim adekuat; në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose të ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare

6. Ofrimi i Shërbimeve të ndihmës sociale nga ana e zyrtarëve përgjegjës të QPS-së luan rolin dhe ka përgjegjësinë për administrimin dhe funksionimin e Skemës së Ndihmave Sociale (Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë).

Kapitulli VIII

MBIKËQYRJA E PUNËS SË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE

Neni 13

Mbikëqyrja e ofruesve të shërbimeve sociale

1. Komuna nëpërmjet Qendrës për Punë Sociale e cila funksionon në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, mbikëqyrë ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare ndërsa Ministria nëpërmjet zyrtarëve të Departamentit përkatës.
2. Ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare bashkëpunojnë me zyrtarët mbikëqyrës dhe ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme.
3. Zyrtari mbikëqyrës jep udhëzime për masat që duhet të ndërmarrin për harmonizimin e cilësisë së shërbimeve me standarde profesionale.

Kapitulli IX

PRONËSIA, BUXHETI DHE FINANCAT

Neni 14

Çështjet buxhetore dhe financiare të QPS-së

1. Pasurinë e QPS-së, e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale që janë të evidentuara si pronë shoqërore të cilat QPS-ja i ka në dispozicion.
2. QPS disponon me mjete dhe pasuri në emër të saj të cilat i përkasin Komunës.
3. Shërbimet sociale dhe familjare financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
4. Çështjet buxhetore dhe financiare të QPS-së administrohen në pajtim me ligjet për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës.
5. Të gjitha shpenzimet operative të QPS-së, mbulohen nga BK.

Kapitulli X

TRANSPARENCA NË PUNË

Neni 15

Transparenca në kuadër të veprimtarisë së QPS-ës.

1. Struktura organizative, kompetenca e QPS, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve sociale në kuadër të veprimtarisë së QPS, janë publike dhe transparente ndaj personave juridik dhe fizik, përveç rasteve kur bëhet fjalë për të dhënat e mirëbesueshme profesionale të mbrojtura me ligj.
2. Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë dhe dokumentacionin u lejohet personave të autorizuar në përputhje me rregullativën ligjore, për qasje në dokumenta publike.

Kapitulli XI

KONFIDENCA PROFESIONALE

Neni 16

Konfidenca Profesionale në Shërbime Sociale

1. Përfituesve të së drejtës në sistemin e shërbimeve sociale duhet tu sigurohet fshehtësia dhe mbrojtja e të dhënave personale në pajtim me ligjin.
2. Të gjithë zyrtarët e shërbimeve sociale dhe familjare duhet që të gjitha informacionet për rastet e trajtuara t'i ruajnë si konfidenciale në të kundërtën janë përgjegjës për shkelje profesionale dhe i nënshtrohen ndjekjes penale.
3. Mosrespektimi i konfidencialitetit nga zyrtari përgjegjës dhe çdo personi tjetër i cili pranon raportime në interes publik do të konsiderohet si shkelje e detyrave të punës.
4. Përpunimi dhe konfidenca e të dhënave personale për përfituesit e shërbimeve sociale dhe familjare duhet të jenë në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nëse nuk është rregulluar ndryshe me ligj të veçantë.

Kapitulli XII

ORGANIZIMI SINDIKAL

Neni 17

Liria e organizimit sindikal

1. Zyrtarët e QPS mund të jenë pjesë e sindikatave dhe me anëtarësimin e tyre vullnetar mund' ti realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës dhe me ligj.
2. Nëse në institucionin e shërbimeve sociale organizohet grevë, varësisht prej veprimtarisë duhet të sigurohet se do të ofrohen shërbimet përkatëse sociale, në mënyrë të papengueshme dhe të vazhdueshme, duke përfshirë në veçanti kryerjen e këtyre punëve:
 - 2.1. pagesa e rregullt e pranimeve në të holla nga përfituesit;
 - 2.2. strehimi, ushqimi dhe mbrojtja shëndetësore e përfituesve të vendosur në institucionet e shërbimeve sociale;
 - 2.3. ndihma dhe përkujdesja në shtëpi;
 - 2.4. shërbimet që nga natyra e tyre nuk mund të shtyhen.

Kapitulli XIII KODI ETIK

Neni 18 Obligimi për respektimin e Kodit Etik

Çdo profesionist i shërbimeve sociale dhe familjare është i obliguar që ta respektojë Kodin etik si ofrues i shërbimeve sociale dhe familjare.

Kapitulli XIV Taksat për ofrimin e shërbimeve administrative sociale

Neni 19 Taksat për ofrimin e shërbime administrative sociale

Taksat për ofrimin e shërbimeve administrative sociale përcaktohen me Rregulloren për Taksa Komunale e miratuar në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Kapitulli XV Dispozitat përfundimtare

Neni 20 Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në faqen zyrtare të komunës .

Arsyetim

Baza ligjore për ta propozuar këtë Propozim-Statut është e përcaktuar me dispozitat e neneve 12 dhe 17 shkronja të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) nenit 48 pika 6, dhe nenit 52 pikës 6 të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 08/L-255 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 1/5 Janar 2024) si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës Lipjan 15Nr. 110 -78095, të datës 24.12.2021.

Me vendim të Kryetarit të Komunës është themeluar grupi punues për hartimin e Projekt-Statutit të Qendrës për Punë Sociale.

Me këtë Propozim Statut është përcaktuar të rregullohet: nocioni, emërtimi, selia, simbolet, statusi juridik prezantimi dhe përfaqësimi, kompetencat dhe përgjegjësitë, veprimtaria dhe shërbimet, pronësia, buxheti dhe financat, transparenca,

kofidencialiteti, etika dhe kompetenca në përcaktimin e taksave për shërbime administrative në kuadër të QPS-së.

Nga të cekurat më lartë me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 08/L-255 me të cilat përcaktohet që Qendra për Punë Sociale duhet të ketë Statutin e saj si akti më i lartë i QPS-së, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim –Statuti.

1Nr. 110/04-11748

Lipjan më 14.03.2025

KRYETARLI KOMUNËS

